



RAPORT
I AKTIVITETIT TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV
AKDIE
PËR VITIN KALENDARIK **2023**



Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të arsitëve interpretues/ekzekutues

AKDIE

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pall. Agimi, shk. 14, hyrja 259 Site : www.akdie.org; email: a.k.d.i.e.albania@gmail.com

RAPORT

I AKTIVITETIT TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV AKDIE

PËR VITIN KALENDARIK 2023

Më datë 20.12.2023, (mërkurë) ora 18.00, me kërkesën e Presidentit të Agjencisë AKDIE, u mbledh **Asambleja e Përgjithshme e Artistëve të AKDIE**, në selinë e saj, me prezencë fizike dhe nëpërmjet platformës Zoom online

Bazuar :

- në ligjin nr. 35/2016 „Për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të“ i ndryshuar
- në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE, nenet 10 dhe 21,
- në Statutin e Agjencisë AKDIE

Asambleja e përgjithshme e Artistëve, në këtë mbledhje pasi diskutoi në mënyrë të detajuar të gjithë aktivitetin e Agjencisë AKDIE përgjatë vitit 2023 , në përfundim mori (2) dy Vendime.

A- me Vendimin nr. 1 datë 20.12.2023 Miratimin dhe dërgimin e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Artistëve, në lidhje me ndryshimin statutor, në gjykatën kompetente për:

1) Konfirmimin e Këshillit Ekzekutiv, për një mandat tjetër statutor, me përbërje:



Z. JANI CEKIXHI	PRESIDENT
LUIZA XHUVANI	ANËTARE
Z. NDRICIM XHEPA	ANËTAR
Z. ARANIT HOXHA	ANËTAR
Z. GRAMAZ BURBA	ANËTAR

2) Konfirmimin e Këshillit të Auditit dhe i Shmangies së Konfliktit të Interesit, për një mandat tjetër statutor, me përbërje:

Z. BUJAR ASQERIU, Kryetar

Zj. SUELA KONJARI, Anëtare

Z. NAUN SHUNDI, Anëtar

3) Konfirmim në detyrë të **Naim ALIAJ, si Drejtor Ekzekutiv.**

B) Gjithashtu, në po të njëjtën mbledhje, Asambleja e Përgjithshme e Artistëve pasi u njoh dhe diskutoi:

1) Veprimtarinë e Agjencisë AKDIE, përgjatë vitit kalendarik 2023, për mënyrën e funksionimit të saj bazuar në legjislacionin në fuqi, performancën e Agjencisë dhe Drejtorit Ekzekutiv në interesin më të mirë të anëtarëve të saj,

2) U njoh me Vendimin nr. 1 datë 15.12.2023 të Këshillit të Auditit dhe Shmangies së Konfliktit të Interesit, mbi auditin e kryer në veprimtarinë e Agjencisë AKDIE, duke e gjetur atë në përputhje të plotë me ligjin dhe me statutin e AKDIE.

3) Shqyrtoi Vendimin nr 1 datë 16.12.2023 të Këshillit Ekzekutiv të AKDIE, i cili i vjen për miratim Asamblesë së përgjithshme të anëtarëve

- Me anë të **Vendimit nr.2 datë 20.12.2023** vendosi, miratimin e veprimtarisë administrative të agjencisë „AKDIE“, për vitin 2023, duke e konsideruar atë, në përputhje me interesin më të mirë të Agjencisë AKDIE, të komunitetit të artistëve dhe në përputhje të plotë me ligjin dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Agjencisë AKDIE.



Bazuar në Ligjin nr 35/2016 i ndryshuar, në Ligjin 8788, datë 7.5.2001 si edhe në Statutin e Agjencisë AKDIE, aktiviteti i Agjencisë AKDIE u verifikua nga:

1- Këshilli i Auditit dhe Shmangies së Konfliktit të Interesit, i cili me **Vendimin nr. 1 datë 15.12.2023** mbi auditin e kryer në veprimtarinë e Agjencisë AKDIE, e gjeti atë në përputhje të plotë me ligjin dhe me statutin e AKDIE

2- Këshilli Ekzekutiv i AKDIE, i cili me **Vendimin nr 1 datë 16.12.2023** konstatoi dhe vendosi:

- Miratimin e aktivitetit financiar të kryer përgjatë vitit 2023 të Agjencisë AKDIE duke konkluduar se, në kushtet kur bazuar në **Ligjin nr 35/2016 të ndryshuar, neni 138 i tij, arkëtimi i të ardhurave nuk kryhet nga AKDIE, por nga SUADA dhe cdo rezultat financiar i aktivitetit të AKDIE është i kushtëzuar nga suksesi apo mospuksesi i SUADA.**
- Pavarësisht përpjekjeve të SUADA, niveli i të ardhurave vazhdon të jetë në nivele shumë të ulëta dhe Agjencia AKDIE është detyruar në pjesën dërrmuese të vitit të funksionojë në kushtet e vështirësive financiare, duke mos garantuar dot as zërin minimal të pagave për punonjësit dhe ofruesit e shërbimit të saj.
- Sipas kontrollit financiar të kryer, mbi të gjithë zërat e shpenzimeve, nga ku doli se shpenzimet e kryera, kanë qënë në dobi të agjencisë dhe në përputhje me qëllimin e agjencisë, legjislacionin në fuqi dhe vecanarisht me atë tatimor, pavarësisht se koston më të madhe e kanë mbajtur stafi i saj, Agjencia AKDIE ka ruajtur me fanatizëm kufirin e lejuar ligjor të shpenzimeve duke përdorur në total **22.8% të të ardhurave për shpenzimet administrative dhe vlerën prej 77% për shpërndarje tek artistët titullarë të drejtash.**
- Janë ruajtur me korrektësi përmbushja e të gjitha detyrimeve tatimore. **(+15%TB si dhe shpenzimet e tjera si sigurimet shoqerore dhe shendetesore, taksa bashkiake etj)**
- Janë ekzekutuar me përpikmëri Vendimet e Këshillit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme të vitit 2022, duke përmbushur pagesat e plota tek artistët shqiptare dhe tek AAK simotra.
- Veprimtaria është në përputhje me interesin më të mirë të saj, nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv Z. Naim ALIAJ, për garantimin e funksionimit të plotë të agjencisë pavarësisht



pamundësisë financiare për të shlyer plotësisht detyrimet karshi punonjësve dhe subjekteve që ofrojnë shërbimet e kontraktuara për AKDIE, duke njohur detyrimin e tyre dhe garantimin për shlyerjen e këtij detyrimi në momenin më të parë të përshtatshëm, dhe duke garantuar një shpërblim dinjitoz për artistët, në shumën **11 701 125 lekë, në vitin 2023 ose 77% të vlerës totale të arkëtuar e cila është 15 196 266 lekë.**

Në këto kushte, bazuar :

1. Në Vendimin nr 2 datë 20.12.2023 e Asamblesë së Përgjithshme, sipas miratimit fizikisht me prezencë dhe online nëpërmjet platformës Zoom,
2. Vendimin nr 1 datë 16.12.2023 të Këshillit Ekzekutiv të AKDIE
3. Në Vendimin nr 1 datë 15.12.2023 të Këshillit të Auditit dhe Shmangies së Konfliktit të Interesit, mbi auditin e kryer në veprimtarinë e Agjencisë AKDIE, duke e gjetur atë në përputhje të plotë me ligjin dhe me statutin e AKDIE.
4. Në ligjin nr. 35/2016 “për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të” i ndryshuar
5. Në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 për organizatat jofitimprurëse, nenet 10, 20 dhe 21,
6. Në statutin e agjencisë AKDIE,
7. Udhëzimi nr. 777/2023, është korniza e ligjit nr. 35/2016 i ndryshuar, mbi tavanin e përqindjes së shpenzimeve të lejuara.
8. Udhëzimi nr. 338/2023, përben zërat e domosdoshëm të shërbimeve që duhet të ofrojë një AAK, për të përmbushur kriteret profesionale, për ekzistencën e një AAK.
9. Neni 605 i kodit civil, rradha e preferimit të përmbushjes së detyrimeve,

KËSHILLI EKZEKUTIV DHE ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

VENDOSI

1. Miratimi i veprimtarisë së Agjencisë AKDIE, si veprimtari në përputhje me interesin më të mirë të saj, nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv Z. Naim ALIAJ, duke shprehur mbështetjen e anëtarësisë për të për garantimin e funksionimit të plotë të agjencisë pavarësisht pamundësisë



financiare për të shlyer plotësisht detyrimet karshi punonjësve dhe subjekteve që ofrojnë shërbimet e kontraktuara për AKDIE, duke njohur detyrimin e tyre dhe garantimin për shlyerjen e këtij detyrimi në momentin më të parë të përshtatshëm, dhe duke garantuar një shpërblim dinjitoz për artistët, në shumën **11 701 125 lekë, në vitin 2023 ose 77% të vlerës totale të arkëtuar e cila është 15 196 266 lekë.**

2. Miratimi i shpenzimeve, përfshirë tatimet, nën rezervën e raportit përfundimtar të Ekspertit Kontabël, për pasqyrën financiare, i gjetur në përputhje me interesin më të mirë dhe në dobi të agjencisë AKDIE, nën parimin e respektimit të detyrimit ligjor të përcaktuar në Ligjin nr 35/2016 të ndryshuar.
3. Shuma për shpërndarje në masën **11 701 125 lekë është likuiduar në pjesën dërrmuese të vet dhe është duke përfunduar plotësisht pjesa e mbetur për artistët e huaj, në përmbyllje të procesit të deklarimeve të shoqërive të huaja.**
4. Për vitin 2023, shpenzimet e Agjencisë AKDIE, janë kryer në përputhje me nenin 151 të ligjit nr. 35/2016 të ndryshuar.
5. Vlera monetare e të hyrave në AKDIE, në vitin 2023 është **15 196 266 lekë**. Kjo vlerë është përdorur në zbatim të ligjit dhe statutit të Agjencisë AKDIE si edhe në përmbushje të urdhërimeve të Vendimeve të Këshillit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme.
6. Detyrimet tatimore të Agjencisë AKDIE, janë përmbushur plotësisht në vlerën **1880925 leke**
7. **Detyrime ndaj të tretëve** të Agjencisë AKDIE janë përmbushur pjesërisht, duke lënë pa paguar plotësisht qiranë e Zyrës , pagën Drejtorit Ekzekutiv si edhe pagat minimale sipas kontratave të shërbimit që AKDIE ka me stafin e saj. Këto detyrime do të shlyhen plotësisht gjatë vitit 2024.
8. **Shpenzime të tjera të kryera janë:**
 - Shpenzime për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit në burim për qiranë-526 791 lekë
 - Shpenzime për web e mirëmbajtje - 194 000 lekë
 - Shpenzime komisionet bankare-44 500 lekë
 - qira zyre e prapambetur e viti 2022 ne shumën - 697 812 lekë
 - shlyerje e pjeshme e pagave të Drejtorit Ekzekutiv për vitin 2022 dhe pjesërisht në vitin 2023 në shumën - 299 540 lekë




- shlyerje fature zyra kontabël Marsela Bushi - 12 000 lekë
- shlyerje faturash shërbimesh ligjore Zyrës Ligjore ART -1 069 981 lekë
- shlyerje fatura shërbimi kompanisë Vidasus - 509793 lekë
- shpenzime për zyrën drita ujë- 90600 lekë
- taksa bashkiake -15 000 lekë
- pagesë shtetërore e certifikatës së fiskalizimit -4000 lekë
- pagesë e programit të fiskalizimit e subjektit MCN-7200 lekë

9. Totali i shpenzimeve të kryera është në vlerën **3 471 217 lekë lekë ose 22.8% e totalit të të ardhurave të hyra në AKDIE.**
10. Do vazhdojë shpërndarja tek artistët shqiptarë dhe të huaj sipas kontratave të përfaqësimit reciprok në vlerën **prej 11 701 125 lekë**, e cila duhet të mbyllet plotësisht deri në Qershor 2024, pasi ka vonesë në procesin e deklarimeve të AAK simotra.

SUBJEKTET PËRDORUESE:

- a/ rezultojnë subjekte përdoruese rreth 80 000 subjekte
- b/ kanë përmbushur detyrimin vetëm 280 subjekte ose 0.35 % e subjekteve



NUMRI I PLOTË I ARTISTËVE NË PËRDORIM DHE RAPORTI I ARTISTËVE TË SHPËRBLIYER:

- a/ në total janë të përdorur dhe të shpërblyer 20094 artistë nga të cilët 405 janë shqiptarë



b/2212 artistë të shpërblyer nga veprat audiovizuale

c/17882 artistë të shpërblyer nga veprat muzikore

d/5945 artistë janë artistë kryesorë të muzikës si këngëtarë apo autorw ne role parwsore



e/11937 artistë janë artistë dytësorë të muzikës si instrumentistë apo korrlistë apo aktorw nw role dytwsore

TË DREJTAT TË ARKËTUESHME:

a/e drejta e transmetimit të fonogramit/videogramit të regjistruar dhe në qarkullim tregtar

b/ e drejta e ritransmetimit kabllor

c/e drejta e komunikimit në publik të veprave të regjistruara paraprakisht në mbajtëse zëri dhe figure



AKTIVITETE TË TJERA



Agjencia AKDIE përgjatë vitit 2023 ka patur rol aktiv në bashkëpunim me SUADA në proceset si më poshtë:

- Kontakte me subjektet e mëdha përdoruese dhe shoqatat përfaqësuese të tyre për negocimin e metodologjisë së re të tarifave
- Kontakte me institucionet rregullatore si Ministria e Kulturës, ashtu edhe me ato ligjzbatuese si ISHMT, Tatime etj me qëllim shtrengimin e zbatimit të ligjit në kushtet kur më pak se 1% e subjekteve përdoruese e zbatojnë ligjin.
- Takime sensibilizuese dhe edukuese për respektimin e ligjit për të drejtat e autorit

MARRËDHËNIET ME JASHTË

- Marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me 22 shoqëritë simotra që AKDIE ka marrëveshje.
- Me krenari mund të themi se AKDIE është agjencia e vetme shqiptare, që ndodh që artistë me famë botërore si **Laura PAUSINI**, zgjedhin të antërsohen drejtpërdrejt në AKDIE.
- Gjithashtu gjigandë botëror si label **UNIVERSAL MUSIC LONDON**, bëjnë kontratë të drejtpërdrejtë me AKDIE për të drejtat e artistëve që ata prodhojnë, me qëllim marrjen e shpërblimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- Negociim me shoqëri dhe entitete përfaqësuese të huaja me qëllim shtrirjen sa më të gjerë të përfaqësimit
- Marrëdhënie bashkëpunuese dhe raportuese me KE lidhur me përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në fushën e IP, ose sa i takon kapitullit VII, në pozicionin e saj AKDIE si grup interesi, përfaqësuese e titullarëve të të drejtave.

MARREVESHJET RECIPROKE APO MARREVESHJE PERFAQESIMI TE AKDIE

ME SHOQERITE E HUAJA

APO ENTITETE JURIDIKE PERFAQESUESE TE ARTISTEVE

NR	SHOQERIA	SHTETI	FUSHA E MBULIMIT	ARTISTE KRYESOR
----	----------	--------	------------------	-----------------



				E/DYTES.
1	AARC	SHBA	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESORE
2	AFM & SAG-AFTRA FUND	SHBA	AUDIO /AUDIOVISUAL	DYTESORE
3	ACTRA PRS	CANADA	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESORE
4	STOART	POLONI	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
5	NUOVO IMAIE	ITALY	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
6	MEDIA IPR UK	UK	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
7	VDFS	AUSTRI	AUDIOVIZUAL	KRYESOR/ DYTESORE
8	ASTERAS	QIPRO	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
9	EJI	HUNGARY	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
10	R.A.A.P	IRLANDE	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
11	GRAMEX / LETER BASHKEPUNIMI	DANIMARKE	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESORE
12	APOLON	GREQI	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
13	CREDIDAM	RUMANI	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
14	ARTISTI	CANADA	AUDIO /AUDIOVISUAL	DYTESORE
15	OFFLIMITS	ITALY	AUDIO /AUDIOVISUAL	KRYESOR/



				DYTESORE
16	LIME BLUE MUSIC	UK	AUDIO / AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
17	CNR INTERNATIONAL	CYPRUS	AUDIO / AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
18	ACTORES S.C.G.	COLOMBIA	AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
19	PPL UK	UK	AUDIO / AUDIVISUAL	KRYESOR /DYTESOR E
20	ATTORNEY CAGLAN TANRIVERDI	TURKEY	AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
21	UNIVERSAL MUSIC NEIGHBOURING RIGHT L.T.D LONDON	UK	AUDIO / AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
22	ARTISTI 7607 ITALY	ITALY	AUDIO / AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE
23	LAURA PAUSINI (REGJISTRUAR SI ANETARE E AKDIE)	ITALY	AUDIO / AUDIOVISUAL	KRYESOR/ DYTESORE

